



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 1107/3, Prot.

Tiranë, më 20/12 /2017

V E N D I M

Nr. 177, Datë 20/ 12 /2017

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË DURRËS "MBI VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO FINANCIARE", PËR PERIUdhËN NGA DATA 01.01.2015 DERI ME DATË 30.06.2017.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori dhe Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se në auditimin e ushtruar në Bashkinë Durrës, rezultuan veprime në mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ku në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë prekur nga gabime materiale mbi nivelin e parashikuar të materialitetit, por jo të përhapura, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko financiare", të ushtruar në Bashkinë Durrës sipas programit auditimit nr. 775/2, datë 24.07.2017, për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.06.2017 në Bashkinë Durrës.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINION I AUDITIMIT:

Bazuar në punën audituese të zhvilluar në subjektin *Bashkia Durrës*, ne konstatojmë që përveç çështjeve të trajtuara në bazë për kualifikimin e opinionit, çështjet e tjera subjekt auditimi, janë në përputhje me kuadrin rregullator që përbën kriteret e vlerësimit mbi të cilën është kryer auditimi.

Auditimi i përputhshmërisë kryer në *Bashkinë Durrës* është në referencë të standardeve të INTOSAI-t, - ISSAI 4000 – 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë”; Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 10-Deklarata mbi Pavarësinë e SAI-t; ISSAI 30-Kodi Etik dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së (Dhjetor 2015), nga ku rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, justifikojnë dhënien e një **Opinionit të Kualifikuar**. Devijimet kryesore në gjykimin tonë materiale lidhen me:

-Bashkia e Durrësit nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke hartuar një plan veprimi për ngritjen e sistemit menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë për zbatimin e tij, si pasojë nuk është zbatuar VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

-Në Bashkinë Durrës akoma nuk është kryer inventarizimi dhe regjistrimi i pronave në ZVRPP; -Nuk është hartuar regjistër i veçantë për pronat e dhëna me qira; -Nuk janë marrë masa par regjistrimin në kontabilitet të pronave të transferuara nga pushteti qendrorë në pushtetin lokal; -Nuk është bërë mundur zbatimimi i kontratave të qirasë për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 12,081,749 lekë.

Asgjësimet e materialeve për inventarët jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata e afat shkurtër në vitin 2016, që i përkasin inventarëve të vitit 2015, nuk kundrojnë me pasqyrën “*Mbi ndryshimet në aktivet e qëndrueshme*” (formati nr. 6), në vlerën 5,560,132 lekë.

- Procedura e ndjekur në vjeljen e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, nuk është në nivelin e duhur, kjo për mos zbatim të procedurave të vjeljes së detyrimeve të cilat kanë çuar në rritjen e nivelit të borxhit nga njëra periudhë në tjetrën.

- Në përgjithësi konstatohet zbatim i ligjshmërisë së LPP, por vërehet mos planifikimi i investimeve në fushat prioritare ku komuniteti ka nevojën dhe fillimin e investimeve pa marrë më parë miratimin nga instancat përkatëse, kryesisht investimet që prekin zonat arkeologjike të këtij qyteti.

-Në zbatimin e procedurave të prokurimeve, konstatohet se në 70% të rasteve të audituara janë shpallur fitues OE me çmim anomalishit të ulët në ofertën e paraqitur, veprimi i cili ka ndikuar në uljen e cilësisë së punimeve dhe jetëgjatësinë e investimit, konstatohet kjo nga auditimi i zbatimit të kontratave ku evidentohen punimeve të pakryera ose të kryera jo sipas projektit.

B. MASA ORGANIZATIVE:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësive publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse (vendimet ekzekutive). Nëpunësi zbatues të

ndjekë procesin me qëllim sistemimin, likuidimin e vlerave, veçanërisht arkëtimin e të ardhurave të munguara nga taksat vendore, **si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Asgjësimet e materialeve për inventarët jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata e afat shkurtër në vitin 2016, që i përkasin inventarëve të vitit 2015, nuk kundrojnë me pasqyrën “*Mbi ndryshimet në aktivet e qëndrueshme*” (formati nr. 6), në **vlerën 5,560,132 lekë**, pasi procesverbali i komisionit asgjësimi datë 10.08.2016 përmban vlerën 21,285,233 lekë, ndërsa në bilanc është shkarkuar për vlerën 26,845,365 lekë, pra shkarkuar më shumë në kontabiliteti për vlerën **5,560,132 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Nëpunësi urdhërues i Bashkisë Durrës, të marrë masa sistemimin e vlerës me dokumentacionin mbështetës, si dhe vënien para përgjegjësisë të personave përgjegjës.

Brenda datës 31.01.2018

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Durrës nuk ka zbatuar pikën 3 e nenit 50 “*Transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucioneve*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku si rezultat i reformës administrative janë larguar nga puna ish/nëpunës të Komunave/dhe Bashkive me status të nëpunësit civil.

Nëpunësit e larguar nga puna në konfliktet gjyqësore me Baskinë Durrës kanë fituar gjyqet, ku gjykata në vendimet respektive ka vendosur kthimin në punë dhe pagesën e pagës deri në momentin e kthimit në punë, për 10 raste me vlerë 10,848,460 lekë.

Gjithashtu nga nëpunësi autorizues nuk është ngritur grup pune për vlerësimin dhe sistemin në punë të nëpunësve me status të nëpunësit civil, pasi pas reformës administrative në bashki janë marrë në punë 77 nëpunës që i përkasin periudhës (viti 2016 dhe 6/mujori 2017). Theksojmë se, efekti financiarë po thellohet në buxhetin e bashkisë, për sa kohë nuk zbatohen vendimet e gjykatave, referuar germës (c) e Kreu IV-të VKM nr. 510, datë 10.06.2015.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të vlerësojë mundësitë e zbatimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës Administrative Durrës vullnetarisht, për të shmangur rritjen e detyrimeve të bashkisë ndaj nëpunësve me status të nëpunësit civil të larguar nga puna.

Brenda datës 31.03.2018

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e të dhënave nga sistemi në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, për periudhën 01.01.2015 – 30.06.2017, u konstatua gjendje e lartë e detyrimeve debitorë me vlerë **113,667,987 lekë për 2207 subjekte**, ku vlerën më të lartë ose 30,7 % e totalit e zënë detyrimet nga subjektet me aktivitet “*Hoteleri dhe restorant*” me vlerë **34,896,091 lekë për 108 subjekte**, detyrime të cilat kanë ardhur si rezultat mos arkëtimin të detyrimeve për taksat e tarifave vendore dhe mos zbatimit të plotë të procedurave për arkëtimin e tyre, në zbatim të nenit 90, 91, 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014.

Gjithashtu në këto subjekte debitor, bëjnë pjesë dhe subjekte të mbyllura ose me status pasiv të cilët nuk kanë bërë të mundur likuidimin e detyrimeve për shumën 10,712,687 lekë nga 1739 subjekte (viti 2015), për vitin 2016 në shumën 5,491,485 lekë nga 156 subjekte dhe për periudhën nga 01.01.2017 deri më 20.09.2017 në shumën 1,025,532 lekë nga 54 subjekte.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Durrës, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë, duke ribërë njoftim vlerësimit tatimore në vlerën **113,667,987 lekë për 2207 subjekte**.

Bazuar në nenin 70 pika 3, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, i ndryshuar, **duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë".

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, si dhe të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të vendosen masa administrative (llogaritja e kamat vonesave) të bëhet kallëzim penal, bazuar në nenin 181, -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

e- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën vendore (pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit), në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".

f- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të kontabilizojë detyrimin në vlerën **43,875,805 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor dhe në bashkëpunim dhe me zyrën e taksave të administrojë listat e debitorëve.

Brenda datës 30.03.2018

4. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi gjatë zbatimit të punimeve, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

4.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve të marri masa për ngritjen e grupeve me specialistët përkatës, për monitorimin e investimeve në terren gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në përfundimin e punimeve.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dosjeve të lejeve zhvillimore të miratuara, u konstatuan mangësi në dokumentacionin plotësues ose dokumentacion i panoterizuar, në pajtueshmëri me ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit Territorit, të marrë masa që në momentin kur subjektet të aplikojnë për Certifikatë Përdorimi përveç të tjerave t'ju kërkojnë subjekteve, sipas rastit, edhe plotësimin e mangësive të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe më pas të lëshojnë Certifikatën e Përdorimit, në zbatim të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Praktikat e dërguara për miratim të Kryetari i Bashkisë, nuk janë shoqëruar me relacion tekniko-ligjor dhe projekt-vendimin për miratimin e lejes zhvillimore, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit Territorit, të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e praktikave të lejeve zhvillimore me relacion tekniko-ligjor dhe projekt-vendimin për miratimin e lejes zhvillimore rast pas rasti.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e qirasë të lidhura me të tretë nga ndërmarrjet e varësisë (respektivisht Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë, sipas kontratave të paraqitura në pasqyrën Aneks 6, bashkëlidhur Raport Auditimit), konstatohet se nuk është bërë derdhjen e detyrimit në favor të Bashkisë Durrës për 50 % të ardhurave nga këto kontrata, veprime në papajtueshmëri me Kapitulli III- *“Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, duke i sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Durrës në vlerën **6,278,269 lekë**, konkretisht: Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit në vlerën 3,589,175 lekë dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë në vlerën 2,689,094 lekë.*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës në bashkërendim me ndërmarrjet e varësisë, Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve financiare për kalimin në favor të Bashkisë Durrës të vlerës vlerën **6,278,269 lekë**, konkretisht: Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit në vlerën 3,589,175 lekë dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë në vlerën 2,689,094 lekë (*Sipas pasqyrës Aneks 6*).

Brenda datë 28.02.2018

8. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Durrës, nuk ka arkëtuar gjobat për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore me padi në gjykatë për 33 raste në vlerën 13,300,000 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

8.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 33 vendime me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura gjatë vitit 2017 në vlerën **13,300,000 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”.

Njëherazi të marrë masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24 -Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”(Sipas pasqyrës Aneks 8, bashkëlidhur Raport auditimit).

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se nga Bashkia Durrës nuk është kthyer përgjigje në afatin e **6 muajve** nga data e marrjes së njoftim të Raportit të Auditimit, në kundërshtim me pikën 2 e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, rezulton se:

-Nga **32** masa organizative me vlerë **109,776 mijë lekë**, janë pranuar nga subjekti 32 masa, nga të pranuarat janë zbatuar **30** masa ose 93.75 %, në proces zbatimi **1** (një) masa ose 3.12 %, ku nga vlera e rekomanduar prej 109,776 mijë lekë është arkëtuar vlera 55,942 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera **53,834 mijë lekë** dhe nuk është zbatuar **1** (një) masa ose 3.12 % e masave.

-Nga **6** masa shpërblim dëmi me vlerë 47,026 mijë lekë, janë pranuar nga subjekti 6 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 4 masa ose 66.6% me vlerë 13,833 mijë lekë ose 29.4%, janë në proces zbatimi 3 masa ose 50 % me vlerë 33,193 mijë lekë, ku nga vlera e rekomanduar prej 33,193 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,491 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera **14,702 mijë lekë**.

-Nga **36** masa disiplinore, janë zbatuar 27 masa sipas rekomandimeve dhe nuk janë marrë në konsideratë 9 masa.

-Nga 2 masa administrative me vlerë **10,300 mijë lekë**, janë pranuar nga subjekti 3 masa, nga të pranuarat janë në proces zbatimi 2 masa me vlera 10,300 mijë lekë, ku nga vlera e rekomanduar prej 10,300 mijë lekë është arkëtuar vlera 2,952 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera **7,348 mijë lekë**.

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës të analizojë me grup pune sipas përkatësive arsyet e mos zbatimit të rekomandimeve dhe të nxjerrë aktet administrative për arkëtimin e shpërblimit të dëmit në vlerën 21,900 mijë lekë, ndaj personave përgjegjës (*sipas rekomandimeve të paraqitura në germën "B" dhe "D"*), dhe të masave organizative me mungesë të ardhurash në vlerën 53,834 mijë lekë, dërguar me shkresën nr. 197/8, datë 30.06.2013, dhe të rikërkuara nga KLSH me shkresën nr. 1016/27, datë 30.6.2014.

Menjëherë

C. MASA SHËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga Titullari i njësisë publike*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 20,253,264 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dy dosjeve të subjekteve me aktivitet "hoteleri dhe restorant", u konstatua të ardhura të munguara në vlerën prej **967,640 lekë**, si rezultat i mos llogaritjes të saktë të taksës së ndërtesës dhe truallit funksional, për sipërfaqen totale që subjekti disponon (ndërtesë + truall funksional) në vitet 2016 - 2017, respektivisht në vlerën **555,200 lekë** për subjektin "R.." A....." shpk, i cili rezulton dhe me gjendje debitorë nga viti 2012 në shumën prej **3,025,614 lekë** dhe vlera prej **412,440 lekë** për subjektin "U... I.." dhe me gjendje debitorë prej **794,430 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit të gjitha rrugët ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën **4,795,684 lekë, respektivisht:**

-**vlera 3,580,814 lekë**, ndaj subjektit "R.." A.." shpk, nga e cila detyrim i pa arkëtuar në vlerën 3,025,614 lekë dhe detyrim pataksuar për taks ndërtesë në vlerën 555,200 lekë.

-**vlera 1,206,870 lekë** ndaj subjektit "U.. I..", shpk, nga e cila detyrim i pa arkëtuar në vlerën 794,430 lekë dhe detyrim pataksuar për taks ndërtesë në vlerën 412,440 lekë.

Brenda datës 28.02.2018

2. Gjetje nga auditimi: Nga Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë (Njësia vartëse e Bashkisë Durrës), janë dhënë me qira kundrejt kontratave prona në administrim të Bashkisë Durrës, sipas VKM nr. 536, datë 01.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Durrës, Qarkut Durrës", ku për vitin 2015 është dhënë një sipërfaqe gjithsej 2077.8 m² dhe për vitin 2016 një sipërfaqe gjithsej 2064.4 m², për të cilat nuk është paguar detyrimi për qiranë në vlerën **995,940 lekë**, nga e cila vlera prej 200,900 lekë për sipërfaqen 717.5 m² (viti 2016) dhe vlera prej 795,040,4 lekë për sipërfaqen 2,839.43 m² (viti 2017).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkërendim me Ndërmarrjen e Tregtisë me Shumicë, të marrë masa që të kontabilizohet dhe arkëtohet

detyrimi në masën prej **995,940 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj qiramarrësve.

Brenda datës 28.02.2018

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Durrës për periudhën objekt auditimi ka lidhur kontrata qiraje me të tretët për dhënie me qira të hapësirës publike plazh, në vitin 2015 për 55 kontrata për vlerë totale 7,900,000 lekë, në vitin 2016 për 143 kontrata për vlerën totale 24,770,660 lekë dhe në vitin 2017 për 203 kontrata për sipërfaqen vlerën totale 32,516,220 lekë. Për të tre vitet rezultoi se është arkëtuar në total vlera 60,379,340 lekë nga 65,186,880 lekë që është detyrimi i lindur nga këto kontrata, duke shkaktuar të ardhura të munguara me dem në **vlerën 4,807,540 lekë nga 14 kontrata.**

3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **4,807,540 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj qiramarrësve qira të hapësirës publike plazh. Bashkia Durrës për 14 qiramarrësit të cilët nuk kanë shlyer detyrimet e mëparshme të mos lidh kontrata për vitin 2018 e në vazhdim (*sipas regjistrit në Bashkinë Durrës dhe pasqyrës Aneksit 7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar Auditimit*).

Brenda datës 28.02.2018

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Rikonstruksion i Rrugës Juba në L. 18, Ish Këneta” me vlerë 26,612,640 lekë, Bashkia Durrës, rezultuan diferenca me dem ekonomik në vlerë 683,350 lekë pa tvsh për punime të pakryera, nga të cilat vlera 369,550 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 313.800 lekë pa tvsh, si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, veprimet në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës dhe mbikëqyrësit të punimeve Ing. AT, Ing. B. S. dhe Ing. F. E, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të demit për vlerën e punimeve të pakryera me vlerën **683,350 lekë pa tvsh** nga OE “S” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 8291, datë 11.12.2014 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Juba në L.18, Ish Këneta”.

Brenda datë 28.02.2018

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Rikonstruksion i Rrugës Rinia Durrsake në L.18, Ish Këneta” me vlerë 23,878,050, Bashkia Durrës, rezultuan diferenca me dem ekonomik në vlerën **556,750 lekë pa tvsh**, për punime të pakryera, në kundërshtim me kontratën nr. 8433, datë 15.12.2014 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Rinia Durrsake në L.18, Ish Këneta”.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të demit për vlerën e punimeve të pakryera me vlerën **556,750 lekë pa tvsh** nga OE “K..” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 8433, datë 15.12.2014 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Rinia Durrsake në L. 18, Ish-Këneta”.

Brenda datës 28.02.2018

6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim i Rrugës Paralel me Murin e Portit” me vlerë 199,898,920 lekë, Bashkia Durrës, rezultuan diferenca me dëm ekonomik në vlerën **8,414,000 lekë pa tvsh** për punime të pakryera, në kundërshtim me kontratën nr. 5176, datë 03.09.2014 lidhur me sipërmarrësin “F..” Shpk, me objekt “Ndërtim i Rrugës Paralel me Murin e Portit”, Bashkia Durrës.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të dëmit për vlerën e punimeve të pakryera me vlerën **8,414,000 lekë pa tvsh** nga OE “F..” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5176, datë 03.09.2014 me objekt “Ndërtim i Rrugës Paralel me Murin e Portit”, Bashkia Durrës.

Brenda datës 28/02/2018

C/1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në **13 procedura** prokurimi me vlerë kontrate **249,442,065 lekë** (me tvsh), janë konstatuar parregullsi në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve sipas DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (a, b, d, dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, shkronja (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, *si më poshtë vijon:*

-Në **8 procedura**, me vlerë kontrate 287,530 mijë lekë pa tvsh (**pa efekt financiar**), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara të prokurimit, duke shpallu fitues OE/BOE me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST.

-Në **2 procedura**, janë konstatuar shkelje në shpalljen fitues të OE, pasi kanë mangësi në plotësimin e kërkesave të DST, duke s’kualifikuar OE me mangësi por me çmim ofertë më të ulët se OE fitues, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike në vlerën **1,503,640 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin e fondeve me impakt negativ në buxhet për vlerën 1,503,640 lekë dhe procedurave pa efekt në vlerë 249,442 mijë lekë, duke favorizuar operatorët ekonomik me kriterë të paplota, në kundërshtim kërkesat e DST dhe dispozitat e LPP.

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim i shkollës Bajram Curri 2” me vlerë të fondit limit 120,287,000 lekë dhe në objektin “Rikonsuksion i rrugës Vrine, fshati Rinia” me vlerë të fondit 99,993,000 lekë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike, rezulton se janë preventivuar me tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke shkaktuar rritje fiktive të fondit limit **në vlerën në 3,389,330 lekë**, nga e cila: për objektin “Ndërtim i shkollës Bajram Curri 2, në

vlerën **2,472,050 lekë** pa tvsh dhe për objektin “Rikonstruksion i Rrugës Vrine, Fshati Rinia” në vlerën **917,280 lekë** pa tvsh.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të analizojë problematikat, të nxjerrë përgjegjësitë dhe eliminojë në të ardhmen praktika të tilla që sjellin efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Durrës, në planifikimin e fondeve.

D. MASA DISIPLINORE

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Durrës që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, për periudhën 01.01.2015 deri më 30.06.2017 për Bashkinë Durrës, **të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 14 punonjësit e mposhtëm:**

-Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c).

1. Znj. H. H, me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

-Për llogaritjen e amortizimit të masën 20% të vlerës së projekteve të ndërtimit në vite, vlerë e cila duhej të ishte kaluar vlerës së objekteve të ndërtuara dhe amortizimi llogaritet sipas vlerës përkatëse të objektit dhe me normë amortizimi në masën 1,38 %, në kundërshtim me udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003” Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” pika (c) “Të ndryshme”.

-Për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në pasqyrat financiare, në lidhje me informacionin kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare, nuk siguron se paraqet mjaftueshëm gjendjen reale të aktiveve, veprime që kanë ndodhur si rezultat i reformës administrative dhe nuk përmbushin kërkesat e SKK të përmirësuara për vitin 2015, të shpallura me urdhër të ministrit financave nr. 64, datë 22.07.2014.

2. Z. A. K, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

-Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Durrës, e konkretisht për mos evidentimin e detyrimeve debitorë tatimore gjatë planifikime të ardhurave vjetore si për vitin 2016 e në vazhdim, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, neni 9, të UMF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

-Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Durrës dhe në mos marrjen e masave shtrënguese si procedurë bllokim aktiviteti që duheshin kryer në bashkëpunim me policinë bashkiake në zbatim të kërkesave të në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9920, datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, dhe ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar për debitorët e biznesit nga viti 2012 e në vazhdim më 31.12.2015 në shumën prej 113,667,987 lekë për 2207 subjekte.

3. Z. S. H, me funksion Specialist në Sektorin e Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore, dhe

4. Z. Sh. H, me funksion Specialist i Sektorit të Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore. Për shkelje të konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Durrës, konkretisht për veprimet e konstatuara nga auditimi i dy dosjeve të subjekteve me aktivitet hoteleri dhe restorant me dëm ekonomike në shumën prej 967,640 lekë, si rezultat i ndryshimit të sipërfaqes së ndërtesës objekt taksimi dhe i mos llogaritjes së taksës së truallit viti 2016 dhe 2017, në kundërshtim me ligjin nr. 142/2015 datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksës vendore , të ndryshuar ”, neni 4/pika 1, neni 8/pika 2/germa (c) , neni 23/pika1, në subjektet “R” A shpk, dhe “U I”,shpk.

5. Z. L. B, me funksion Specialist në Sektorin e të Ardhurave në DTTV.

-Për shkelje të konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Durrës, pasi ka kryer ngarkesë në sistem për subjektin “R” A” shpk, pa kërkuar certifikatën e pronësisë, dokumenteve ligjore të cilat janë përcaktuar nga DTTV Durrës në formularët e aplikimit të kërkesave pranë DTTV Durrës të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Durrës, dhe në mungesë të akteve të kontrollit nga të inspektorëve të terrenit.

- Në 2 raste, duke patur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të OE/BOE nuk është i drejtë dhe duhet të ishin s’kualifikuar, siç është vepruar dhe me OE/BOE e tjerë. Në këto raste procedurat duhej të ishin anuluar dhe vijuar me operatorin tjetër në radhë të kualifikuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, respektivisht ne procedurat “Rikonstruksion rruga Vrinë – Fshati Rinia”, me vlerë fondi limit 99,993 mijë lekë” dhe “Rrugë mbi kanalin kullues K-192 Plazh, loti I”, me fond limit 83,499 mijë lekë.

6. Znj. J. R, me funksion ish- Drejtore e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Durrës dhe në mos marrjen e masave shtrënguese si procedurë bllokim aktiviteti që duheshin kryer në bashkëpunim me policinë bashkiake në zbatim të kërkesave të në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9631, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar për debitorët e biznesit nga viti 2012 e në vazhdim më 31.12.2015 në shumën prej **113,667,987 lekë për 2207 subjekte**.

7. Zj. D. B, me funksion Drejtoresh e Drejtorisë Ligjore, në cilësinë e anëtarit të KVO, për praktikën e mëposhtme:

- “Rikonstruksion rruga Vrinë – Fshati Rinia”, me vlerë fondi limit 99,993 mijë lekë”.

8. Zj. A. M, me funksion Specialist Prokurimesh në Drejtorinë Ligjore, dhe

9. Z. A. B, me funksion Specialist në Drejtorinë e të Ardhurave, në cilësinë e anëtarit të KVO, për praktikën e mëposhtme:

-“Rikualifikim fasadash (Blloku përballë rrugës paralele me murin e Portit), me vlerë fondi limit 83,331 mijë lekë.

10. Zj. M. S, me funksion Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve, dhe

11. Zj. E. P, me funksion Specialist në Drejtorinë e Taksave Vendore, në cilësinë e anëtarit të KVO, për praktikën e mëposhtme:

-“*Rikualifikim fasadash në qytet*”, me fond limit 89,948 mijë lekë.

12. Zj. A. M, me funksion Përgjegjës në Sektorin e Pronave Publike;

13. Zj. I. Xh, me funksion Drejtoreshë e Politikave të Zhvillimit, dhe

14. Zj. E. K, me funksion Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, për praktikën e mëposhtme:

-“*Rrugë mbi kanalën kullues K-192 Plazh, loti I*”, me fond limit 83,499 mijë lekë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Punonjësit e mësipërm sipas praktikave që kanë administruar në pozicionin e anëtarit të KVO, kanë kryer shkelje administrative në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66 (Trajtuar në faqen 52-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Durrës**, që bazuar në performancën e punës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, në Bashkinë Durrës për periudhën 01.01.2015 deri më 30.06.2017, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 1 (një) punonjësit:**

-“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”

7. Z. Zh. V, me funksion Zv/Kryetar i Bashkisë Durrës, në cilësinë e Kryetarit të KVO, për praktikën e mëposhtme:

- “*Rikonstruksion rruga Vrincë – Fshati Rinia*”, me vlerë fondi limit 99,993 mijë lekë”.

-“*Rrugë mbi kanalën kullues K-192 Plazh, loti I*”, me fond limit 83,499 mijë lekë.

-“*Rikualifikim fasadash (Blloku përballë rrugës paralele me murin e Portit)*, me vlerë fondi limit 83,331 mijë lekë.

-“*Rikualifikim fasadash në qytet*”, me fond limit 89,948 mijë lekë.

-“*Rikonstruksion çerdhja nr. 2*”, me fond limit 8,332 mijë lekë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Punonjësit e mësipërm sipas praktikave që kanë administruar në pozicionin e anëtarit të KVO, kanë kryer shkelje administrative në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66 (Trajtuar në faqen 52-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmerret veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ